



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 494/17 Prot.

Tiranë, më 22.7. 2022

URDHËR

Nr. 444, Datë 22.7.2022

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË INTEGRUAR TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË “ODONTOIATRIA E
PROTESI DENTARIA” TË UNIVERSITETIT “ALBANIAN UNIVERSITY”, NË
BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E FERRARËS, ITALI**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 dhe të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të përbashkët, të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Odontoiatria e Protesi Dentaria”, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, të Universitetit “Albanian University”, në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës, Itali, që realizohet me 360 kredite dhe kohëzgjatje normale 6 vite akademike (12 semestra), në gjuhën italiane, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e integruar e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Odontoiatria e Protesi Dentaria”, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, në Universitetin “Albanian University” dhe Fakultetin respektiv në Universitetin e Ferrarës Itali, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e përbashkët, të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Odontoiatria e Protesi Dentaria”, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Universitetin “Albanian University” dhe Fakultetin respektiv në Universitetin e Ferrarës Itali, fillon në vitin akademik 2022-2023.
3. Universiteti “Albanian University”, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti “Albanian University”, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, të lëshuar nga ky universitet, pranë Qendrës

së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Albanian University”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

